



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/11/23,
Datë: 03.02.2023.

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut, neni 31 i Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vleresimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Kuvendi i Komunës ne mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me dt.03.02.2023 nxjerrë:

VENDIM

- I. Miratohet Raporti i Vleresimeve të dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut në Komunën e Junikut të datës: 17-18-19/01/2023.
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është i Raporti i Vleresimeve të dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut në Komunën e Junikut të datës: 17-18-19/01/2023, i hartuar nga Komisioni Komunal për vleresimin e dëmeve nga reshjet e shiut.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
Z. Shpejtim Gacaferi





01-180-975
11
31 01 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	31.01.2023
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	z.Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës së Junikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për seancë të jashtëzakonshme

I nderuar,

Duke u bazuar në nenin 44 paragrafi 44.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale, Rregulloren (QRK) Nr.17/2015 Për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, kërkojmë që të mbahet seancë e jashtëzakonshme lidhur me dëmet nga Vërshimet e Janarit 2023 në Komunën e Junikut me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të dëmeve të shkaktuara nga Vërshimet e Janarit 2023.

Duke pasur parasysh rëndësinë e kompensimit të dëmeve si në kuadër të infrastrukturës publike, po ashtu për pronat private, kërkojmë që ky raport të aprovohet nga ana juaj.

Bashkëngjitur me këtë kërkesë, ju paraqesim Raportin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e datës: 17,18, 19 Janar 2023.

Me respekt!



P



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

DATE/A:	24 JANAR 2023
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Albin Kurti, Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës
cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës së JUNIKUT
NGA/OD/FROM:	z. Shkelzen Shehu, Kryetar i Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet në Komunën e Junikut, Janar 2023
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e e Komunës së Junikut

I nderuar,

Bashkëngjitur gjeni raportin e komisioneve për vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Junikut.

Si pasojë e motit të ligë që ka mbizotëruar në territorin e Komunës së Junikut, gjegjësisht, reshjeve të pandërprera të shiut, të datës (17,18 ,19).01.2023, kanë bërë që shtrati i lumit Erenik dhe Trrava si dhe përroskat të dalin nga shtretërit e tyre, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në fshatrat që shtrihen buzë pellgut të lumit Erenik. Bazuar në vlerësimin e komisioneve, dëmi i shkaktuar nga këto vërshime është në shtëpi banimi, , infrastrukturë i cili llogaritet të jetë mbi 118,550.00 €.

Këtij raporti i'a bashkëngjisim edhe disa nga fotot e bëra në vend të ngjarjes


Nr	Dëmi i shkaktuar	Përshkrimi i dëmit	Numri i	Vlera në €	Vërejtje
01.	Shtëpi banimi	Vërshim i shtëpive dhe i objekteve ndihmëse	Dëmtimi i shtëpisë së banimit privat – janë dëmtuar kuzhina(1500€), shporeti elektrik(350€), divanet (400€), frigoriferi(250€), vetura(500€), dëmtim fasadash të murit(500€).	Gjithsej Vlera 3,500.00€	

02.	Infrastrukturë	Dëmtimi në infrastrukturë rrugore/kanalizim, ura dhe diga.	-Rrëshqitjet e dheut në skarpitet sipër dhe poshtë rrugës Junik-Jasiq-Gjocaj në këto lokalitete Livadhi i Bojsë 50 m³, Mulliri i Sylsë-Prioni i Bojsë në dy vende me vlerë 10000 m³, Lagjja e Malokëve në fshatin Gjocaj 700 m³, Rampa e vjetër në fshatin Jasiq 200 m³, rruga Junik-Gjocaj në Gunovcë të fshatit Gjocaj (pronë private) 300 m³, rruga malore nga Juniku për tek kaptazha e ujësjellësit në Blinajë afër Lagjes Gacafer 300 m³, rrëshqitje e dheut në rrugën lokale në lagjen Jaruha të Junikut 50 m³. Të gjitha këto sasi janë materiale inerte apo zhavorre të përziera të cilat duhet të largohen apo sjellën në vendet respektive për të sanuar gjendjen ashtu siç ishte para dëmtimeve nga vërshimet. -Dëmtim Bankinash në lokalitetet Mulliri i Rrustemve në fshatin Jasiq 100 m³, Rruga Junik-Jasiq-Gjocaj 1000m³, rruga në lokalitetin Lluga e Begut në Junik 50 m³. -Dëmtimi i pendës në lumin Trrava në lagjen Jaruha në Junik në gjatësi prej 40 m³. -Dëmtimi i shtresës së asfaltit në rrugën Junik-Jasiq-Gjocaj tek lokaliteti rampa e vjetër në sipërfaqe prej 450 m². -Dëmtime shtesë në shtratin e lumit Erenik në lokalitet Arasha dhe Zalli në lagjen Berishë të Junikut.	Largim dhe sjellje dherash e Inertesh së bashku me gërmim ngarkim bartje dhe rrafshim në varësi të lokacionit komplet V= 11600 m³ x 4,5 = 52,200.00€ Dëmtim bankinash L= 1150 m³ x 3,0 = 3,450.00 € Dëmtim i pendës së ujitjes 40,000.00€ Dëmtim i shtresës së asfaltit 450 x 12 = 5,400.00€ Shtrati i lumit Erenik 200 m³ x 70 =14,000.00€ Komplet 115,050,00€ (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë euro)	
03.	Objekte afariste	Dëmi në biznese dhe ekonomi familjare		€	
04.	Bujqësi	Dëmi në sipërfaqe me të mbjella, serra dhe ferma familjare	- X Ha - X serra	€	
Totali				118,550,00€ (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind	

				pesëdhjetë euro)
--	--	--	--	------------------

Foto për dokumentim





Mulliri i Sylsë-
Prroni i Bojsë



Mulliri i Sylsë-
Prroni i Bojsë



Mulliri i Sylsë-
Prroni i Bojsë



Mullini i Sylsë-
Prioni i Bojsë




Lagjeja Malok në Gjocaj



Rampa e vjetër
në Jasiq

Asfalti i dëmtuar në lokacionin
rampa e vjetër në fshatin Jasiq



Dëmtimi i bankinës së
rrugës në lokalitetin
Mulliri i Rustemve në
fshatin Jasiq





Rrëshqitje e dheut në
lokalitetin Gunovc në
fshatin Gjocaj

Dëmtimi i shtratit të lumit
Erenik në lokalitetin Arasha
në lagjen Berishë në Junik





Shtrati i lumit Erenik i dëmtuar
në lagjen Berishë në Junik



Lagjeja Berishë në Junik,
lumi Erenik



Te plasurat në pendën e
betonit në lagjen Jaruha
në Junik.

Me respekt...

Totali i dëmeve ne pronat publike dhe private eshte:118,550.00€

Komisioni:

- Shkëlzen Shehu – Udhëheqës i Njësisë së Zjarrfikësve dhe Zyrtar për Gatishmëri dhe Emergjenc - kryesues
- Turim Ganiqaj – Udhëheqës i Sektorit për Sh. Publike – anëtar,
- Xhavit Jasiqi- Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm – anëtar,
- Fluriye Shehu – Zyrtare e Lartë për Kadastër – anëtare dhe





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/13
Datë: 28.02.2023

Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja e) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut dhe miratohen nga Kuvendi i Komunes, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 28.02.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për emerimin e anëtarëve të komisionit për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave.

I. Me këtë vendim bëhet emërimi i anëtarëve të Komisionit për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave.

II. Komisionin e përbejnë 11 anëtarë.

1. Demokrat Ganiqaj – Kryesues i komisionit
2. Rrustem Pepshi - anëtar
3. Arian Xhuli - anëtar
4. Turim Ganiqaj - anëtar
5. Ali Gacaferi - anëtar
6. Vjollca Qestaj - anëtare
7. Idriz Gacaferi - anëtar
8. Valbona Gaxherri-Gacaferi - anëtare
9. Mursel Salihaj - anëtar LDK
10. Erleta Qestaj - anëtare
11. Xhemë Tofaj - anëtar

III. Komisioni është përgjegjës për hartimin e Draft – Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim.

III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947
<http://rks-gov.net/junik>

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria e SHPIMSH-së
4. Të apostrofuarit në pikën II;
5. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
6. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim GACAJERI





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/14
Datë: 31.03.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të ligjit për vetëqeverisje lokale (Ligji nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 27 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji nr. 03/L-048, GZRK numër 2008/27) dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4 të Statutit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më datë 31.03.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

për

ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake të vitit 2022

- I. Me këtë vendim miratohet propozimi i kryetarit të Komunës së Junikut për ndryshimin e planit të buxhetit për shkak të rritjes së të hyrave vetanake gjatë vitit 2022 sipas tabelës dhe sqarimit si në vijim:

Tabela e planit dhe realizimit:

Nr.	Te hyrat	Planifikimi	Realizimi vjetor 2022	Diferenca (+, -)
1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	11,481.00	14,472.86	2,991.86
2	Te hyrat nga urbanizmi	19,100.00	12.00	-19,088.00
3	Te hyrat nga administrata	7,100.00	6,654.50	-445.50
4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	10,000.00	12,330.57	2,330.57
5	Te hyrat nga tatimi ne pronë dhe në tokë	92,557.00	96,238.45	3,681.45
6	Regjistrimi i Automjeteve	6,000.00	7,668.00	1,668.00
7	Te hyrat nga shëndetësia	6,200.00	6,210.50	10.50
8	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	4,100.00	2,180.00	-1,920.00
9	Të hyrat tjera	144,219.19	202,602.25	58,383.06
	TOTALI	300,757.19	348,369.13	47,611.94

Shuma totale e të hyrave vetanake të inkasuara në periudhën Janar – Dhjetor 2022 duke përfshirë të gjitha të hyrat është gjithsejtë: **348,369.13€**. Shuma e planifikuar për vitin 2022 është **159,038.00€**, gjatë vitit 2022 është bërë ndryshimi i këtij plani në shumë prej 141,719.19, Totali i planifikimit pas këtij ndryshimi është **300,757.19€** ku shifet se kemi tejkalim të inkasimit të të hyrave vetanake për vitin 2022 në vlerë prej **47,611.94€** në këtë shumë janë të përfshira edhe të hyrat nga Gjybat në trafik në shumë prej 8,077.50€.

Në mënyrë që të mundemi të alokojmë tejkalimin e të hyrave, kërkojmë që të rritet planifikimi i të hyrave vetanake në shumë prej **47,611.94€**, totali i të hyrave për vitin 2022 të rritet nga 300,757.19€ në 348,369.13€.

Kjo rritje në vlerë prej **47,611.94€**, të bartet si në vijim :

- Nën programi 48020 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Bashkëfinancimi i projekteve me kod të projektit 46030 – 47,611.94€.


- I. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në realizimin e të gjitha procedurave administrative lidhur me ndryshimin e planit të buxhetit për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2022, nga pika I, e këtij vendimi.
- II. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse përveç vetëqeverisjes lokale, si dhe publikimi në gjuhët zyrtare në web faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës;
5. Arkivi Komunal.

Kuvendi i Komunës së Junikut
z. Shpejtim Gacaferi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/15
Datë: 31.03.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të ligjit për vetëqeverisje lokale (Ligji nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 27 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji nr. 03/L-048, GZRK numër 2008/27) dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4 të Statutit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më datë 31.03.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

për

bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2022 për shpenzim në vitin 2023.

- I. Me këtë vendim miratohet propozimi i kryetarit të Komunës së Junikut për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara në vitin 2022, për shpenzim në vitin 2023. Shuma e mbetur për bartje është **195,150.60 €** ku kërkojmë që bartja të bëhet në këto Programe dhe kategori ekonomike si vijon:

Të hyrat e vitit 2022 – fondi 21 në total prej 195,144.42€ bartet si në vijim:

Kategoria e investimeve kapitale 155,470.61€

- Shuma prej **14,050.00 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 51315 **“Asfaltimi i rrugës lokale Junik - Jasiq”**, në Programin Shërbime publike me kod 180, në nën programin Infrastruktura rrugore me kod 18020.
- Shuma prej **5,000.00€** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 53232 **“Furnizimi me gjenerator për objektin e Komunës”**, në Programin Administrata dhe Personeli me kod 163, në nën Programin Administrata me kod 16320.
- Shuma prej **56,420.61 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 46030 **“Bashkëfinancimi i projekteve”**, në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020.
- Shuma prej **55,000.00 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin (Projekt i ri) **“Kanalizimi i ujërave te zeza lokacioni, Moronicë dhe lagjja Krasniq”**, në Programin Planifikim Urban dhe Mjedis me kod 660, në nën Programin Planifikimi Urban dhe inspeksioni me kod 66405.
- Shuma prej **20,000.00 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin (Projekt i ri) **“Ndërtimi i mureve mbrojtëse lokacioni Tofaj dhe**

Pepsh", në Programin Planifikim Urban dhe Mjedis me kod 660, në nën Programin Planifikimi Urban dhe Inspeksioni me kod 66405.

- Shuma prej **5,000.00 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin (Projekt i ri) **"Furnizimi me pajisje për analiza laboratorike në QKMF"**, në Programin Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale me kod 730, në nën Programin Shërbimet e shëndetësisë primare me kod 74200.

Kategoria e mallrave dhe shërbimeve 39,609.63€

- Shuma prej **30.609.63 €** të bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Programin Planifikim Urban dhe Mjedis me kod 660, në nën Programin Planifikimi Urban dhe Inspeksioni me kod 66405.
- Shuma prej **5,000.00 €** të bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Programin Shërbime publike me kod 180, në nën programin Infrastruktura rrugore me kod 18020.
- Shuma prej **4,000.00 €** të bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Programin Arsimi dhe Shkenca me kod 920, në nën programin Administrata me kod 92100.

Kategoria e Subvencioneve 64.18€

- Shuma prej **64.18 €** të bartet në kategorinë ekonomike subvencione, në Programin Zyra e Kryetarit me kod 160, në nën Programin Zyra e Kryetarit me kod 16020.

Të hyrat e bartura në vitin 2022 – fondi 22 në total prej 6.18€ bartet si në vijim:

Kategoria e investimeve kapitale 6.18€

- Shuma prej **6.18 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 46030 **"Bashkëfinancimi i projekteve"**, në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020.

Në total të hyra për bartje nga viti 2022 në vitin 2023 nga fondi burimor 21 dhe 22 janë 195,150.60 €

- II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në realizimin e të gjitha procedurave administrative lidhur me bartjen e mjeteve financiare nga pika I. e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse përveç vetëqeverisjes lokale, si dhe publikimi në gjuhët zyrtare në web faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës;
5. Arkivi Komunal.

Kuvendi i Komunës së Junikut
z. Shpejtim Gacalëri





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/16
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 12.1, nenit 14 pika 1, nenit 17 paragrafi c), nenit 58 shkronja h) dhe nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040) (Gazeta Zyrtare nr. 28 e dt. 04.06.2008), neni 27 të Ligjit Nr. 06/L. -092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 34 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e procedurave për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; nenit 10 paragrafi a) dhe b) , si dhe nenit 22 paragrafi 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.03.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për

shpalljen e parcelave kadastrale numer P-73105038-00491-2, 00491-3, 00491-4 me interes të përgjithshëm publik i Komunës së Junikut

- I. Miratohet Vendimi për Shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësimin e Njesisë Kadastrale si në vijim :
P-73105038-00491-2, P-73105038-00491-3, dhe P-73105038-00491-4 Zona kadastrale Junik.
- II. Objekt i shpalljes interes i përgjithshëm publik janë pronat e paluajtshme të cekura në pikën I , të këtijë Vendimi në sipërfaqe të përgjithshme prej 15924 m2, cilat gjenden në vendin e quajtur “ Baks – Fabrika “ , ku e njehta evidentohet në emër të Pasurisë Shoqërore, Industria e Bashkuar e Tekstilit Emin Duraku – Gjakovë.
- III. Qëllimi i paraqitjes së këtijë Vendimi për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të njesisë kadastrale të cekur si në nenin I të këtijë Vendimi është Shpronësimi i kësaj Njësie Kadastrale për nevoja të Komunës së Junikut , në të cilat planifikohet Industri të Lehtë dhe ushqimore dhe projekte të ndryshme.

Vlera e kompensimit për pronën që do të shpronësohet do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuader të Ministrisë së

Financave në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015, për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme, që do të shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin

IV. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria e Planifikimit Urban Pronë, Kadaster dhe Mjedis, në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 28 tetor 2010 do të drejtohet Qeverisë së Republikës së Kosovës (Departamentit të Shpronësimit) për fillimin e procedurës së shpronësimit.

Pas miratimit të këtij Vendimi për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e kryetarit, Drejtoria për Urbanizëm, Kadaster dhe Mjedis dhe Drejtoria e Financave.

V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Zyra e Kryetarit;
3. Drejtoria për Urbanizëm, Kadaster dhe Mjedis
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut
z. Shpejtim Gacaferi

Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office : JUNIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Junik

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m²
P-73105038-00491-2	Parcelë / Parcela / Parcel	14467
P-73105038-00491-4	Parcelë / Parcela / Parcel	606
P-73105038-00491-3	Parcelë / Parcela / Parcel	851



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2500

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 14.03.2023

Koha/ Vreme/ Time: 10:47:50

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



CERTIFIKATË / CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : P.SH. INDUS.E BASHKUE TEKSTILIT E.DURAKUGJA

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: Data dhe koha e dëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: Komuna / Opština / Municipality: Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:		6-942/3-2200 14.03.2023 - 10:50 JUNIK / JUNIK / JUNIK JUNIK / JUNIK / JUNIK
--	--	--

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Lidat broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shprehës apo regjistrimit Drzava državljanstva ili ukupljenja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijuar në datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P.SH. INDUS.E BASHKUE TEKSTILIT E.DURAKUGJA			/	KCID0503250	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
JUNIK / JUNIK / JUNIK			JUNIK	

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njesia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësitë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Katë/ Katet Et./ Sprat Floor number	Vendi i qendrës Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Ažurirano Updated
P-73105038-00491-2	JUNIK / JUNIK / JUNIK	Junik / Junik / Junik	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna imovina Privately owned Land /		BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA	14467	Tokë Ndërtimore - Shfrytëzimi - / Tokë Ndërtimore - Oborrt - / / Gradjeviniku zemljište - Kucos Zgrada - / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - House-Building - / Construction land - Back Yard - / /	1 / 1	Poseëim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-73105038-00491-3	JUNIK / JUNIK / JUNIK	Junik / Junik / Junik	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna imovina Privately owned Land /		BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA	851	Rajon Ujor - Prion/Perrua - / / Vodeni Region - Potok - / / / Water - stream - / /	1 / 1	Poseëim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-73105038-00491-4	JUNIK / JUNIK / JUNIK	Junik / Junik / Junik	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna imovina Privately owned Land /		BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA	606	Rajon Ujor - Prion/Perrua - / / Vodeni Region - Potok - / / / Water - stream - / /	1 / 1	Poseëim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	

Flurije Shehu



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/17
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 12.1, nenit 14 pika 1, nenit 17 paragrafi c), nenit 58 shkronja h) dhe nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040) (Gazeta Zyrtare nr. 28 e dt. 04.06.2008) , neni 27 të Ligjit Nr. 06/L -092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës , neni 34 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e procedurave për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; nenit 10 paragrafi a) dhe b) , si dhe nenit 22 paragrafi 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.03.2023 nxjerrë:

VE N D I M

për

shpalljen e parceles kadastrale numer P-73105038-00069-0 me interes të përgjithshëm publik i Komunës së Junikut

- I. Miratohet Vendimi për Shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësimin e Njesisë Kadastrale si në vijim :
P-73105038-00069-0 Zona kadastrale Junik.
- II. Objekt i shpalljes interes i përgjithshëm publik janë pronat e paluajtshme të cekura në pikën I , të këtijë Vendimi në sipërfaqe të përgjithshme prej 20839 m2, e cila gjendet në vendin e quajtur “ Mali Madh – Livadhi Madh “ , ku e njehta evidentohet në emër të Pasurisë Shoqërore, OPPB “ Kosovodervo “ , Prishtinë OP “ Gjeravica “.
- III. Qëllimi i paraqitjes së këtijë Vendimi për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të njesisë kadastrale të cekur si në nenin I të këtijë Vendimi është Shpronësimi i kësaj Njesisë Kadastrale për nevoja të Komunës së Junikut , në të cilën planifikohet të destinohet për zhvillim ekonomik, respektivisht **Qendër për Rekreacion dhe Turizem .**

Vlera e kompensimit për pronën që do të shpronësohet do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuader të Ministrisë së Financave në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së

Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015, për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme, që do të shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin

IV. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria e Planifikimit Urban Pronë, Kadaster dhe Mjedis, në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 28 tetor 2010 do të drejtohet Qeverisë së Republikës së Kosovës (Departamentit të Shpronësimit) për fillimin e procedurës së shpronësimit.

Pas miratimit të këtij Vendimi për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e kryetarit, Drejtoria për Urbanizëm, Kadaster dhe Mjedis dhe Drejtoria e Financave.

V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Zyra e Kryetarit;
3. Drejtoria për Urbanizëm, Kadaster dhe Mjedis
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut
z. Shpejtim Gacalari

Kryesues





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLAJA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : JUNIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Junik

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-73105038-00069-0	Parcelë / Parcela / Parcel	20839



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2500

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 14.03.2023

Koha/ Vreme/ Time: 10:45:06

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojilo/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Transportit dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-73105038-00069-0

Numbri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

6-942/3-2200

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

14.03.2023 - 10:48

JUNIK / JUNIK / JUNIK

Junik / Junik / Junik

JUNIK / JUNIK / JUNIK

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komunalne / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numbri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronësisë Vrsta imovine Property Type	Zana U/R GrS U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-73105038-00069-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena imovina / Socially owned Land		20839			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
MALI MADH-LIVADHI-MADH				

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korëzënja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto korëzënje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti klase Quality Class	Sipërfaqja Përfaqja Area (m ²)
1	Pjorë/ëmburor/Forestry	Tokat Pjorë/ëmburor/Forest	Mal i Klasës 2/Suma 2 Klasse/2nd Class Forest	20719
2	Tokë Ndërtimore/Gradëvinsko zemëjtare/Construction land	Shtëpi/Mëbriqez/Kuca-Zgrada/House-Building		120

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lidni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinačni adrese Address details	Pjesa e pronës Dio Imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar/ Ažurirano Updated
Powedim individual / Individualna Drzavica / Single possessor	P.SH.OPPB KOSOVODRVO PRISHTINE OP GJERAVICA	KC/D0503194	DEQAN / DEQAN / DEQAN /		EDVARD KARDELI	1/1		

Edvard Kardeci




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : JUNIK
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Junik

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m ²
P-73105038-00069-0	Parcelë / Parcela / Parcel	20839



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2500

Punoi/Obredio/Created:

Data/ Data/Date: 14.03.2023

Koha/ Vremë/ Time: 10:45:06

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beloška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/18
Datë: 31.03.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.03.2023 nxjerrë:

V E N D I M

**për hapjen e diskutimit publik për
projekt Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Junikut**

- I. Me këtë vendim hapet diskutimi publik për projekt Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Junikut, /në tekstin e mëtejme Planit/.
- II. Projekt Planit nga pika I. e këtij vendimi vihen në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.
- III. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
- IV. Ekspozimi i projekt Planit do të bëhet në zyrën për SIIPM dhe SH, të objektit të Komunës së Junikut.
- V. Diskutimi publik i projekt Planit zgjat 15 ditë (fillon më: 10.04.2023 dhe përfundon më: 25.04.2023).
- VI. Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Planit ekspozohet edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.
- VII. Diskutimi publik i projekt Planit organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Drejtoria për SHPM dhe SH, e Komunës së Junikut.
- VIII. Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të këtij projekt Planit.
- IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria e SIIPM dhe SH, e Komunës së Junikut.

X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për SHPM dhe SH;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut
z. Shpejtim Gacaferi





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPSTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/19
Datë: 31.03.2023 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.03.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për

plotësim ndryshimin të pjeshëshem të Rregullores për orarin e punës të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut

I. Me këtë vendim bëhet plotësim ndryshimi i pjeshëshem i Rregullores për orarin e punës të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut /në tekstin e mëtejme Rregullorja/.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja e miratuar nga pika I. e këtij vendimi.

III. Plotësim ndryshim i kësaj Rregulloreje është Neni 12, pika c (dita e pushimit të përcaktohet nga subjektet) duhet të jetë **c. Një ditë pushimi brenda jave, të përcaktohet nga vetë subjektet.**

III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Junikut.

IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen Neni 12 , pika c të dispozitës ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Shërbime publike mbrojtje dhe shpëtim;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe

Adresa:

Tel.: (383 (0) 44 271 947

<http://kk.rks-gov.net/junik>

5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim Gacaferi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/20
Datë: 20.04.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numer 001/26) dhe nenit 8 paragrafi 8.6 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut, **Komiteti për Komunitetene** mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 21.03.2022 nxjerrë:

V E N D I M

për

zgjedhjen e kryesueses të Komitetit për Komunitete

- I. Me këtë vendim zgjedhet znj. Zejnepe Gaxherri kryesuese e Komitetit për Komunitete / në tekstin e mëtejme kryesuese/.
- II. Kryesuesja është e obliguar që të kryesojë mbledhjet e Komitetit për Komunitete në përputhje me nenin 9 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut.
- III. Mandati i kryesueses është i njëjt me mandatin e anëtarëve të tjerë të Komitetit për Komunitete.
- IV. Procedura e shkarkimit apo e zëvendësimit të kryesueses është e njëjtë me procedurën e zgjedhjes.
- V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet e tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e kryesuesit të mbledhjes inaguruese të Komitetit për Komunitete dhe shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e Departamentit Ligjor të MAPL-së

Me këtë vendim njoftohen:

1. I zgjedhuri nga pika I. e këtij vendimi,
2. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
3. Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i mbledhjes inaguruese

z. Shpejtim GACAFERI

Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/21
Datë: 20.04.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numer 001/26) dhe nenit 8 paragrafi 8.6 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut, **Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 01.03.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për

zgjedhjen e kryesueses të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

I. Me këtë vendim zgjedhet z. Beqë Knushi kryesues i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara / në tekstin e mëtejshme kryesuesi/.

II. Kryesuesi është i obliguar që ti kryesojë mbledhjet e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në përputhje me nenin 9 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut.

III. Mandati i kryesuesit është i njëjt me mandatin e anëtarëve të tjerë të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.

IV. Procedura e shkarkimit apo e zëvendësimit të kryesuesit është e njëjtë me procedurën e zgjedhjes.

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet e tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VI. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e kryesuesit të mbledhjes inaguruese të Komitetit për Komunitete dhe shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e Departamentit Ligjor të MAPL-së

Me këtë vendim njoftohen:

1. I zgjedhuri nga pika I. e këtij vendimi,
2. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
3. Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i mbledhjes inaguruese

z. Shpejtim GACA/ERI

Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/22
Datë: 20.04.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numer 001/26) dhe nenit 8 paragrafi 8.6 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut, Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 09.03.2023 nxjerrë:

V E N D I M

për

zgjedhjen e kryesueses të Komitetit për Shërbime Publike

- I. Me këtë vendim zgjedhet znj. Festina Maloku kryesuese e Komitetit për Shërbime Publike / në tekstin e mëtejshme kryesuesi/.
- II. Kryesuesja është e obliguar që ti kryesojë mbledhjet e Komitetit për Shërbime Publike në përputhje me nenin 9 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut.
- III. Mandati i kryesueses është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të tjerë të Komitetit për Shërbime Publike.
- IV. Procedura e shkarkimit apo e zëvendësimit të kryesueses është e njëjtë me procedurën e zgjedhjes.
- V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet e tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e kryesuesit të mbledhjes inaguruese të Komitetit për Komunitete dhe shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e Departamentit Ligjor të MAPL-së

Me këtë vendim njoftohen:

1. I zgjedhuri nga pika I. e këtij vendimi,
2. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
3. Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i mbledhjes inaguruese

z. Shpejtim GACAFERI



Adresa:
Tel.: +383 (0) 44 270 947
<http://rks-gov.net/junik>